



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/27
Datë: 10.07.2026

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 10, paragrafi 11, të Ligjit Nr. 10/L-001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2026, në pajtim me nenet 65 dhe 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 10 korrik 2026, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet alokimi i ndarjeve buxhetore në shumën prej 2,240,000€ (dy milionë e dyqind e dyzet mijë eurosh) për Radio Televizionin e Kosovës (RTK).
2. Mjetet sipas pikës 1. të këtij Vendimi alokohen nga ndarjet buxhetore të planifikuara për Radio Televizionin e Kosovës (RTK), me kodin buxhetor 248, sipas Ligjit Nr. 10/L-001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2026, në kategorinë e shpenzimeve "Subvencione dhe transfere".
3. Mjetet sipas pikës 1. të këtij Vendimi alokohen dhe transferohen nga Thesari në llogarinë e përcaktuar nga Radio Televizioni i Kosovës (RTK), në bankë komerciale.
4. Obligohen Ministria e Financave dhe Radio Televizioni i Kosovës (RTK) për zbatimin e këtij Vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/27
Datë: 10.07.2026

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 19/A të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i plotësuar dhe i ndryshuar me Ligjin Nr. 04/L-115, Ligjin Nr. 05/L-080 dhe Ligjin Nr. 06/L-023, në pajtim me nenet 65 dhe 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 10 korrik 2026, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Kërkesa e Agjencisë Kosovare të Privatizimit për kthimin e fondeve në shumën prej 48,216.57€ (dyzetetetë mijë e dyqindëgjashtëmbëdhjetë euro e pesëdhjeteshtatë centë), të transferuara në Buxhetin e Republikës së Kosovës, për Ndërmarrjen Shoqërore NSH "Magjistrala".
2. Mjetet buxhetore merren nga kodi i pranimi të këtyre të hyrave, nga llogaria kryesore e Fondit të Republikës së Kosovës dhe kthehen në llogarinë e ndërmarrjes shoqërore, sipas pikës 1. të këtij Vendimi, me qëllim që ndërmarrjet shoqërore të kenë mjete të mjaftueshme për të përmbushur kërkesat kreditorë, apo për të mbuluar shpenzimet e likuidimit, sipas prioriteteve të përcaktuara në nenin 40 të Shtojcës së Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit.
3. Obligohen Ministria e Financave dhe Agjencia Kosovare e Privatizimit për zbatimin e këtij Vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë